



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria –Vlada-Government*

**Ministria e Tregtisë dhe Industrisë**  
**Ministarstvo Trgovine i Industrije**  
**Ministry of Trade and Industry**



**Drejtoria e Akreditimit e Kosovës**  
**Direkcija za Akreditaciju Kosova**  
**Directorate of Accreditation of Kosovo**

## **Raporti vjetor për vitin 2014 i Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit e Kosovës**

Drejtoria e Akreditimit e Kosovës (DAK) edhe vitin 2014 e përmbylli me sukses. Kjo dëshmohet edhe me rritjen e numrit të Trupave të Vlerësimit të Konfomitetit të cilat u akredituan gjatë vitit 2014, si rrjedhojë e punës intensive të stafit të DAK-së dhe interesimit gjithnjë e më të madh të sektorëve të biznesit për t'u akredituar. Përmirësimi i vazhdueshëm i performancës si dhe ofrimi i shërbimit gjithnjë e më të mirë dhe me kompetencë që stafi i DAK-së pati deri më tani.

Krahasuar me vitet e tjera, DAK ka pasur një progres dukshëm më të madh. Këtë vit DAK u vlerësua për herë të dytë nga vlerësues të Korporatës Evropiane të Akreditimit (EA). Vlerësimi i DAK është bërë në javën e parë të muajit nëntor dhe pa mbylljes së jo-konformiteteve të gjetura DAK do të nënshkruan MLA (BLA), marrëveshjen multilaterale me EA (European co-operation for Accreditation) dhe me atë rast certifikatat që do të lëshojnë laboratorët testues të akredituara nga DAK-u do të njiheshin në tërë Evropën e edhe në botë pasi që EA ka marrëveshje me IAF (Organizata Botërore e Akreditimit) dhe ILAC (Organizata Ndërkombëtare e Laboratorëve të Akredituar), e që DAK-u është anëtare e të dy organizatave ndërkombëtare e akreditimit.

Angazhimi maksimal, vlerësimi i pavarur, profesional dhe me kompetencë do i mundësoj DAK-së pranimin e vlefshmërisë së sistemit të akreditimit si në rajon dhe më gjerë dhe kjo do të kontribuojë ekonomisë dhe shoqërisë Kosovare në zvogëlimin e kostove të prodhimit, zëvendësimin e produkteve të importuara me produkte vendore si dhe rritjen e eksportit.

Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës (DAK) ofron shërbimin e akreditimit të:

- ✓ Laboratorëve testues, kalibrues dhe medicinal;
- ✓ Trupave certifikues dhe
- ✓ Trupave inspektues;

Gjatë vitit 2014 aktivitet e DAK kanë qenë dukshëm të shtuara andaj edhe për të realizuar këto aktivitet DAK ka punuar në mënyre intensive. Gjithashtu mund të shtojmë se këtë vit në DAK jo

vetëm që janë shtuar aktivitetet e akreditimit për Laboratorë Testues, por janë shtuar edhe aktivitetet e vlerësimit të Trupave Inspektues.

Akreditimet gjatë vitit 2014:

**Laborator Testues (LT):**

1. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, Laboratori i Ushqimit dhe Veterinarisë
  - 2.1 Sektori i analizave të qumështit
  - 2.2 Sektori i mikrobiologjisë ushqimore
  - 2.3 Sektori i kimit të ushqimore dhe mbetjeve veterinarë
  - 2.4 Sektori i serologjisë
2. Departamenti i Vreshtarisë dhe Verërisë –MBPZHR, Laboratori i testimit të verërave
3. "AK-Company" Sh.p.k, Laborator i testimit të betonit, produkteve të tij dhe përzierjeve bituminoze
4. Stonecastle Vineyards & Winery L.L.C, "Laboratori SC V&W" për analizimin e parametrave kimiko-fizik të verërave dhe pijeve të forta alkoolike
5. "EUROLAB" SH.P.K, Laborator i kontrollimeve teknike të automjeteve
6. FERPLAST, Laboratori për kontrollimin e masave plastike
7. IMN"Test-Beton" SH.P.K, Laboratori për ekzaminimin e materialeve ndërtimore, beton, asfalt dhe agregate
8. "G&B-Tamponi" Sh.p.k, Laboratori i përzierjeve bituminoze dhe hulumtime gjeomekanike

**Trupa Inspektues (TI):**

1. "ADRIAINSPEKT KOSOVA " SH.P.K, Inspektimi i cilësisë së karburanteve të lëngëta të naftës dhe inspektimi i cilësisë së gazrave të lëngëzuar të naftës
2. "EURO-INSPEKT" N.SH, Inspektimi i cilësisë së naftës dhe derivateve të naftës
3. Qendra e Automjeteve të Kosovës (QAK), Inspektimi për homologim të automjeteve

**Ri-akreditimet gjatë vitit 2014 :**

1. "ADEA GROUP" Sh.p.k, Laborator për analiza kimike dhe mikrobiologjike të ujit (riakreditim)
2. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës- IKSHPK Qendra e Laboratorëve Testuese
  - 2.1 Laboratori për analiza të ujit të pijes dhe ujërave rekreative
  - 2.2 Laboratori i kontrollit të cilësisë së ushqimit
  - 2.3 Laboratori mikrobiologjik i ushqimit dhe ujit
3. "Ballkan Petrol" N.T.P, Laborator për analiza të vajrave
4. Company "Eskavatori" Sh.p.k., Laboratori për analiza fiziko-mekanike të agregatit, përzierjeve bituminoze dhe bitumit

**Mbikëqyrjet gjatë vitit 2014:**

**Laborator Testues (LT)**

1. Laboratori "Ballkan Projekt" N.P.N, Laboratori për shqyrtimin e materialit ndërtimor, beton, asfalt si dhe hulumtime gjeomekanike dhe gjeologjike të dherave
2. Korporata Fito sanitare „Sara & Meti“, sh.p.k, Laboratori Analitik, Bujqësor dhe i Ushqimit
3. Fabrika për prodhime farmaceutike „Trepfarm“, Kontrolli i cilësisë së produkteve farmaceutike „Trelab“
4. "ALDI CONSTRUCTION" SH.P.K, Laborator për analiza të betonit

5. "SIERRA LAB", Laborator për analiza të naftës dhe derivateve të lëngëta të naftës
6. Laboratori "ERAMET", Laborator për kalibrimin e masës dhe kalibrim të volumit
7. "ETL-Kosova", Laborator për ekzaminimin e materiale ndërtimore dhe shqyrtimin e konstruksioneve nga betoni
8. "Kosova-Lab", Laborator për analiza të naftës dhe derivateve të lëngëta të naftës,
9. N.P."IPE-PROING", Laborator për analiza fiziko-mekanike të materialeve ndërtimore dhe strukturave të ndërtimit
10. N.SH. "AGROVET", Laborator testues për materialet agrogjeologjike, agroekologjike, teknologjike, ushqim dhe ujë
11. Sharrcem "Titan Groop Company", Laborator për analiza të çimentos
12. SH.A "BIRA PEJA", Laborator për analiza kimike-fizike dhe mikrobiologjike për birra, lëngje, ujë dhe çaj të ftohtë
13. N.SH "Test & Ing", Laboratori i përzierjeve bituminoze dhe hulumtimeve gjeomekanike
14. "Ex Fis LABS" SH.P.K, Laboratori për analiza të derivateve të naftës

**Trupa Inspektues (TI):**

1. Saybolt Pan Ardiatika d.o.o, Njësia në Kosovë, Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së karburanteve të lëngëta të naftës dhe inspektimi i cilësisë së gazrave të lëngëzuara të naftës
2. "KPU Inspect" Sh.p.k, Inspektimi i cilësisë së karburanteve të lëngëta të naftës dhe inspektimi i cilësisë së gazrave të lëngëzuar të naftës
3. "ADRIAINSPEKT KOSOVA " SH.P.K, Inspektimi i cilësisë së karburanteve të lëngëta të naftës dhe inspektimi i cilësisë së gazrave të lëngëzuar të naftës

Akreditime (LT)	8
Akreditime (TI)	3
Riakreditime (LT)	4
Mbikëqyrje (LT)	13
Mbikëqyrje(LK)	1
Mbikëqyrje (TI)	3
Tërheqja (LT)	4

Tab.1. Paraqitja tabelore e aktiviteteve të DAK në procedurat e vlerësimit të Trupave të Vlerësimit të Konformitetit (TVK).




Fig.1 Paraqitja grafike e aktiviteteve te DAK në procedurat e vlerësimit të Trupave të Vlerësimit të Konformitetit (TVK), LT (Laborator Testues), TI (Trup Inspektues) LK (Laborator Kalibrues).

Me kërkesë të Departamentit të Industrisë ekipi i vlerësimit i DAK-së ka realizuar vizita vlerësuese me qëllim të vlerësimit të kompetencës teknike për dy trupa inspektuese te cilit kanë të bëjnë me inspektimin e ashensorëve të udhëtarëve, ashensorëve të ngarkesave dhe ashensorëve special. Gjithashtu me kërkesë të Departamentit të Industrisë janë realizuar edhe dy mbikëqyrje të jashtëzakonshme ndaj trupave të autorizuar për naftë dhe derivate të naftës me qëllim të verifikimit nëse këta trupa inspektuese janë duke punuar në bazë të kërkesave të standardit ISO/IEC 17020:2012.

Akreditimi i TVK-ve në periudhën 5 vjeçare:

Viti 2010	8
Viti 2011	11
Viti 2012	17
Viti 2013	25
Viti 2014	32




Fig.2 Paraqitja në formë grafike e TVK-ve të akredituar në periudhën 5 vjeçare 2010-2014

Numri rendor	TVK të akredituara nga DAK sipas standardit	Numri i TVK të akredituara
1	Laborator testues (LT) KS EN ISO/IEC 17025	26
2	Laborator kalibrues (LK) KS EN ISO/IEC 17025	1
3	Trupa Inspektues (TI) KS ISO/IEC 17020	5

Tërheqja e akreditimit është bërë tek laboratorët:

1. **LT/11/005, “FAN”Sh. p. k-** Laboratori për analiza të vetive mekanike për armature dhe njejve të saldimit,
2. **LT/12/009, “M&Sillosi” Sh.p.k-** Laboratori për analiza të miellit, grurit, himeve, brumërave, sneksit, vajit dhe bukës,
3. **LT/16/015, “Renelual Tahiri”**, Laborator i materialit ndërtimor
4. **LT/21/33, “Derivati”**, Laborator i derivateve të lëngëta të naftës

### Objektivat dhe Aktivitetet e DAK në të ardhmen

Në përputhje me objektivat strategjike dhe politiken e cilësisë, aktivitete e DAK-së për vitet e ardhshme do të jenë të fokusuar në:

- ✓ Angazhim të më tejshëm për përmirësimin dhe plotësimin e procedurave të DAK dhe të gjithë sistemit të akreditimit në DAK i cili do të harmonizohet me praktikën e BE-se,
- ✓ Zgjerimi i aktiviteteve në fusha të reja të akreditimit bazuar në nevojat e palëve të interesit,
- ✓ Ngritjen e nivelit të kompetencës së të gjithë pjesëmarrëseve në procedurat e akreditimit si të stafit permanent të DAK-së ashtu edhe të ekspertëve të jashtëm,

- ✓ Përmirësimin e bashkëpunimit me palët e interesit, (ministritë përkatëse, konsumatorët dhe TVK-ve të akredituara si dhe asociacioneve të tyre) me qëllim të përfshirjes sa më të madhe të të gjitha palëve të interesit,
- ✓ Promovim të vazhdueshëm të rëndësisë së akreditimit në infrastrukturën e cilësisë.

### **Bashkëpunimi i DAK me organizmat qeveritar të vendit**

DAK-ja vazhdon bashkëpunimin e saj me organet e qeverisjes për zbatimin e procedurave të akreditimit për TVK, me organet përkatëse të qeverisë që japin autoritetin për zbatimin e rregullave teknike në sigurinë ushqimore, të produkteve industriale të sigurisë së mjedisit, shëndetësisë, mbrojtjen e konsumatorit dhe fushave të reja tjera të interesit publik sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 16/2011 “ Për Mënyrën e Autorizimit të Trupave për Vlerësimin e Konformitetit “.

### **Bashkëpunimi i DAK-së në nivelin Evropian dhe Ndërkombëtarë**

Drejtoria e Akreditimit e Kosovës, bashkëpunon me të gjitha organizmat akreditues të vendeve të Ballkanit dhe po punon për institucionalizimin e këtij bashkëpunimi duke nënshkruar disa Marrëveshje Bashkëpunimi. DAK deri tani ka nënshkruar MoU me:

1. Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit (DPA) të Republikës së Shqipërisë
2. Institutin e Akreditimit nga Republika e Maqedonisë (IARM)
3. Agjencinë Turke të Akreditimit (TURKAK), Republikën e Turqisë
4. Agjencinë Kroate të Akreditimit (HAA), Republika e Kroacisë
5. RENAR ( Romanian Accreditation Association), Rumania

Ndërsa DAK është e anëtarësuar edhe në këta organizma ndërkombëtar të akreditimit:

1. Organizata Ndërkombëtare e Akreditimit të Laboratorëve, **ILAC** (International Laboratory Accreditation Cooperation).
2. Forumi Ndërkombëtar i Akreditimit, **IAF** (International Accreditation Forum).
3. Anëtarë shok (associate member) me **EA** (Europeanco-operation for Accreditation).

### **Trajnimet e organizuara nga DAK**

Drejtoria e Akreditimit e Kosovës (DAK) edhe këtë vit zhvilloi dy trajnime me temën “Kërkesa të përgjithshme për kompetencën e laboratorëve testues dhe kalibrues” SK EN ISO/IEC 17025: 2007. Në trajnim morën pjesë 45 pjesëmarrës, kryesisht ishin persona përgjegjës për implementimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit në laboratorë të akredituar dhe laboratorë që janë në procesin e vlerësimit. Objektivat e trajnimeve, ishin njohja me kërkesat e menaxhimit kapitullit 4 dhe kërkesat e kompetencës teknike kapitulli 5 i standardit SK EN ISO/IEC 17025:2007. Trajnues ishin përfaqësues të stafit të DAK-së. Në fund të secilit trajnim të pranishmeve iu ndanë certifikata për pjesëmarrje në trajnim.

DAK gjithnjë e më shumë po arrin që të rris dhe përmirësoj kompetencën e stafit dhe vlerësuesve teknik nëpërmjet trajnimeve. Rol të rëndësishëm në këtë aspekt pati edhe mbështetja e DAK-së nga projekti IPA 2008 dhe PTB. Përmes projektit gjerman PTB stafi i DAK u trajnua në Turqi, Greqi, Itali, Kroaci etj. ku trajnerët ishin nga shtetet e BE-së dhe trajnimet ishin në fusha të ndryshme të akreditimit.

**Takimet rajonale të DAK-ut**

Edhe gjatë vitit 2014, DAK vazhdoi me pjesëmarrjen aktive në takimet e Asamblesë Gjenerale të EA-së (EA-GA) dhe në komitetin për Marrëveshje Multilaterale (EA MAC) me nga dy takime në vit.

Për shkak të buxhetit të vogël DAK nuk ka mundur të përcjell takimet e ILAC dhe IAF dhe takimet tjera të ftuara ndërkombëtare.

**Aktivitetet e tjera të DAK-së**

Me 16 qershor 2014 DAK organizoi një manifestim rasti me qëllim të shënimit të Ditës Botërore të Akreditimit. Moto e këtij takimi ishte promovimi i akreditimit: “Një testim, një certifikim, një akreditim” ose „Një produkt i testuar njëherë, pranohet kudo”.

Rimëkëmbja ekonomike dhe ri-industrializimi i vendit nuk do të jetë e mundur pa infrastrukturën e duhur teknike ku institucionet ofrojnë shërbime për testime, matje dhe kalibrime të aparaturave me të cilat përcaktohet cilësia e produkteve. Për zhvillim të suksesshëm DAK, duhet të sigurojë fonde të vazhdueshme dhe të qëndrueshme, hapësira për burime njerëzore për kryerjen e vlerësimeve për akreditim.

Për shkak të rritjes së vazhdueshme të numrit të aplikacioneve të reja për akreditimin e TVK dhe rritjes së vëllimit të punës, DAK ka paraparë të angazhoj edhe dy punëtorë në sektorin për akreditim. Punonjësit e rinj do të përfshihen në programet e trajnimit intensiv për tu aftësuar për kryerjen e procedurave të vlerësimit për akreditimin e TVK-ve.

Ibush Luzha